



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

BASHKIA DIBËR

Nr. 538 Prot., datë 07.02.2025

56h/H 07/02
Nr. Prot., datë __.__.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

DHE

BASHKISË DIBËR

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

e njohur më poshtë si “**DPPI**”

DPPI është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”.

DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).

Adresa e institucionit është: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Ish - Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga titullari:

Znj. Maria Solis – Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar,

DHE

BASHKISË DIBËR

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra. Relievi i bashkisë së re është përgjithësisht kodrinor dhe malor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi si dhe me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shtrira në një zonë të thellë.

Adresa e institucionit është: Rr.Nasi Pavllo, Pallati “Edil-Al” Shkalla 1, Kati 3, Ap.8 përfaqësuar nga titullari:

Z. Rahim Spahiu- Kryetar i Bashkisë Dibër

Neni 1

Rëndësia e Bashkëpunimit

Duke patur parasysh se:

1. Pronësia Intelektuale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomiko-sociale dhe kulturore të një vendi;

2. Ekziston një nevojë imediate për mbështetjen ligjore dhe institucionale të pronësisë intelektuale, me qëllim mbrojtjen e saj;
3. Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbushin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, që angazhohen në këto veprimtari;
4. Palët shprehin dakordësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik mbi pronësinë intelektuale dhe përçimin e saj.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas modaliteteve të mëposhtme:

Neni 2

Qëllimi i Bashkëpunimit

Fokusi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, kryesisht do të jetë në përfshirjen në aktivitete të përbashkëta, panairë, me qëllim sensibilizimin e subjekteve tregtare në bashkinë e qytetit të Dibrës.

Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

1. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim mbrojtjen dhe regjistrimin e objekteve të pronës industriale, për bizneset e Dibrës;
2. Organizimit e tryezave të rrumbullakta të përbashkëta dhe sesione bisedimesh, mbi mbrojtjen dhe regjistrimin e pronës industriale, me fokus Treguesit Gjeografikë;
3. Shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, nga Palët, kur ato e shohin të arësyeshme.

Neni 4

Modalitetet e Bashkëpunimit

1. Secila Palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; konkretisht nga pala e DPPI-së, do të jetë Drejtoria e Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës.
2. Ngritja e një grupi të përbashkët pune, për konkretizimin e bashkëpunimit me veprimtari të ndryshme;
3. Organizimin dhe vënien në dispozicion për publikun e gjerë, të informacionit dhe rezultateve të çdo veprimtarie të përbashkët;
4. Grupet e përbashkëta, do të përpunojnë mënyrat dhe veprimet e përbashkëta, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 5

Afati i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje, lidhet për një afat të pacaktuar. Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, mund të ndryshojë me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

Kjo marrëveshje, mund të shfuqizohet me kërkesën e njëres palë, pas njoftimit paraprak me shkrim, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, që parashtron edhe arsyet e prishjes së kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Nënshkrimi dhe Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot, më datë / /2025, në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

PALËT:

Për:

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPP)**

ZNJ. MARIA SOLIS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR



Për:

BASHKINË DIBËR

Z. RAHIM SPAHIU

KRYETAR

